| **ALARM TATIMOR** | **TAX ALERT** |
|---|---|
| **Janar 2020** | **January 2020** |
| Për t'ju informuar me ndryshimet më të fundit në legjislacionin Shqipëtar, ky alarm tatimor i përgatitur nga "A.R.S Legal & Financial Services" shpk, ju ofron informata të vlefshme për personat fizikë dhe personat juridikë. | To keep you up to date with the latest changes in Albanian legislation, this tax alert prepared by "ARS Legal & Financial Services" Ltd provides you with valuable information for natural persons and legal entities. |
| *Në Fletoren Zyrtare Nr. 182 datë 30.12.2019 është publikuar Ligji Nr. 90/2019* ***"Për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme".*** | *In the Official Journal No.182, dated 30.12.2019 is published Law no. 90/2019* ***"On the revaluation of real estate".*** |
| Sipas pikës 1 të ligjit të gjithë individët, të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, kanë të drejtë që nga data 14.01.2020, deri në datën 30 shtator 2020 të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut. | According to point 1 of the law, all individuals who own real estate have the right, from date 14.01.2020, until September 30, 2020 to re-evaluate this property according to market value. |
| Objekt i këtij ligji është rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme të personave fizikë dhe juridikë, përfshirë rivlerësimin e pasurive të paluajtshme që janë në proces regjistrimi, dhe rivlerësimin e pasurive të legalizuara. | The object of this law is the revaluation of real estate of natural and legal persons, including the revaluation of real estate that is in the process of registration, and the revaluation of legalized property. |
| **PËR PERSONAT FIZIKË** | **FOR NATURAL PERSONS** |
| Ky rivlerësim mund të bëhet nga një ekspert i licencuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme nga institucionet përkatëse ose nga zyrat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. | This revaluation can be done by a licensed real estate expert from the relevant institutions or local offices of the State Cadastre Agency. |
| Në rast se individi zgjedh që të bëjë rivlerësimin me një ekspert të licencuar, atëherë aplikimit të tij për rivlerësim të pasurisë së paluajtshme i bashkëlidh edhe aktin e vlerësimit të ekspertit. | If the individual chooses to make a re-evaluation with a licensed expert, then to the application for revaluation of real estate is attached also the act of evaluation of the expert. |
| Zyrat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës përllogarisin: | The local offices of the State Cadastre Agency calculate:<br><br>a) the taxable base, which is calculated as the difference between the value |

a) bazën e tatueshme, e cila llogaritet si diferenca ndërmjet vlerës së pasqyruar në akt ekspertimi, e cila nuk mund të jetë më e vogël se çmimet minimale fiskale, dhe vlerës së pasurisë të aktit të regjistruar ose vlerës së rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi;
b) tatimin që duhet të paguajë individi për ta regjistruar këtë rivlerësim.

Në rast se individi zgjedh që rivlerësimi të kryhet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me çmimet minimale fiskale në fuqi, atëherë ky fakt shprehet në formularin që i bashkëlidhet aplikimit të tij për rivlerësim. Në këtë rast zyra vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës përllogarisin:

a) bazën e tatueshme, e cila llogaritet si diferenca ndërmjet vlerës së dalë nga rivlerësimi me çmimet minimale fiskale në fuqi dhe vlerës së pasurisë të aktit të regjistruar ose vlerës së rivlerësuar, për të cilën është paguar tatimi;
b) tatimin që duhet të paguajë individi për ta regjistruar këtë rivlerësim.

Në rastet kur pasuria e paluajtshme rezulton e regjistruar pa një kontratë shitjeje, atëherë si vlerë regjistrimi, në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, konsiderohet vlera e çmimeve minimale fiskale në çastin e regjistrimit të aktit të fitimit të pronësisë.

Tatimi që paguhet për regjistrimin e këtij rivlerësimi është 3 për qind e bazës së tatueshme.

**PËR PERSONAT JURIDIKË**

Personat juridikë, të cilët kanë të regjistruar në pasqyrat e tyre financiare pasuri të paluajtshme me vlerë më të vogël se ajo e tregut, kanë të drejtë të bëjnë, brenda periudhës së zbatimit të

reflected in the expert act, which may not be less than the minimum fiscal prices, and the value of the asset of the registered act or revalued value for which it was paid the tax;
b) the tax that the individual must pay to register this revaluation.

If the individual chooses to perform the revaluation by the State Cadastre Agency at the minimum fiscal prices in force, then this fact is stated in the application form attached to his re-evaluation aplication. In this case the local office of the State Cadastre Agency calculates:

a) the taxable base, which is calculated as the difference between the revaluation value at the minimum fiscal price in force and the value of the asset of the registered act or revalued value for which the tax is paid;
b) the tax that the individual must pay to register this revaluation.

In cases where the real estate turns out to be registered without a sale contract , then as the registration value, in the State Cadastre Agency, is considered the value of the minimum fiscal prices at the moment of registration of the act of acquisition of ownership.

The tax payable for registration of this revaluation is 3 percent of the taxable base.

**FOR LEGAL ENTITIES**

Legal entities, which have registered in their financial statements real estates with a value of less than the market, have the right, within the period of application of this law, to re-evaluate with the market value these property.

| | |
|---|---|
| këtij ligji, rivlerësimin me vlerën e tregut të këtyre pasurive.<br><br>Rivlerësimi me vlerën e tregut bëhet nga ekspertë të pavarur, të licencuar për vlerësimin e pasurisë.<br><br>Diferenca ndërmjet vlerës që rezulton nga rivlerësimi, me vlerën kontabël të pasurisë, reflektohet në pasqyrat financiare të vitit 2020.<br><br>Personat juridikë, për këtë rivlerësim, paguajnë 5 për qind të diferencës ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël të regjistruar, për pasuritë e paluajtshme<br><br>*Në fletoren zyrtare Nr. 188 datë 13.01.2020 është publikuar Udhëzimi Nr. 30, datë 30.12.2019 për disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 17 datë 3.8.2016* ***"Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërise, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit".***<br><br>PËR NJËSIMIN E DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE<br><br>Aplikimi për njohjen dhe njësimin e certifikatave dhe diplomave universitare të nivelit 5 deri në nivelin 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK), kryhet on-line sipas procedurës së mëposhtme:<br><br>a) formulari i aplikimit plotësohet on-line në portalin e-albania. Këtij formulari i ngarkohet në format elektronik dokumentat që do të listohen më poshtë: | Revaluation at market value is done by independent experts, licensed for property valuation.<br><br>The difference between the resulting revaluation value and the carrying amount of the property is reflected in the 2020 financial statements.<br><br>Legal entities, for this revaluation, pay 5 percent of the difference between the revaluation value and the carrying amount registered for real estate.<br><br>*In the Official Journal No.188, dated 13.01.2020 is published the Instruction no. 30, dated 30.12.2019 for some changes in the Instruction no. 17, dated 3.8.2016* ***"On the procedures and criteria for recognition and in equalization the Republic of Albania of diplomas, certificates, scientific degrees and academic degrees issued by foreign higher education institutions and other authorized institutions abroad".***<br><br>ON THE EQUALIZATION OF DIPLOMAS AND CERTIFICATES<br><br>The application for the recognition and equalization of university certificates and diplomas of level 5 to level 8 of the Albanian Qualifications Framework (AQF) and the European Qualifications Framework (EQF) is performed on-line according to the following procedure:<br>a) the application form is completed on-line at the e-albania portal. The documents listed below will be uploaded to this electronically form:<br><br>b) diplomas / certificates, or relevant official document in the country of origin equivalent to the diploma; |

b) diploma/certifikata, ose dokumenti zyrtar përkatës në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton

c) përfundimin e studimeve, kopje e njësuar me origjinalin, si dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar;

d) lista e notave dhe/ose suplementi i diplomës (nëse ka), të njësuar me origjinalin, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar;

e) kopje e kartës së identitetit ose e pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj);

f) mandatpagesa ose konfirmimi i pagesës online.

PËR NJËSIMIN E GRADËS SHKECORE "DOKTOR"

Aplikimi për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore "Doktor", kryhet on-line sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet on-line në portalin e-albania. Këtij formulari i ngarkohet në format elektronik dokumentat që do të listohen më poshtë:

b) diploma dhe suplementi i saj (nëse ka të tillë), lëshuar nga institucioni përkatës i arsimit të lartë, që dëshmon fitimin e gradës shkencore "Doktor", kopje e njësuar me origjinalin, si dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar;

c) diploma e studimeve pararendëse universitare dhe/ose vërtetimi i njësimit të diplomës i lëshuar nga institucioni përgjegjës;

d) disertacioni i doktoratës;

e) fotokopja e kartës së identitetit ose e pasaportës (për shtetasit e huaj);

c) certifying completion of studies, a copy attached to the original, and translated into albanian by licensed translators;

d) the list of grades and / or diploma supplement (if any), attached to the original, and translated into albanian by licensed translators;

e) copy of identity card or passport (for foreign nationals only);

f) payment order or confirmation of online payment.

ON EQUALIZATION OF SCIENTIFIC GRADE "DOCTOR"

The application for recognition and equalization of the scientific grade "Doctor", is performed on-line according to the following procedure:

a) the application form is completed on-line at the e-albania portal. The documents listed below will be uploaded to this electronically form:

b) diploma and its supplement (if any), issued by the relevant higher education institution, attesting to the award of a "Doctor" degree, a copy of the original, and translated into albanian by a licensed translator. ;

c) diploma of pre-university studies and / or diploma certification issued by the responsible institution;

d) doctoral dissertation;

e) photocopy of ID card or passport (for foreign nationals);

f) payment order or confirmation of online payment;

g) the applicant must submit a copy of the dissertation to the National Library

ON EQUALIZATION OF "PROFESSSOR" AND "ASSOCIATED PROFESSOR" TITLE

f) mandatpagesa ose konfirmimi i pagesës online;

g) aplikanti duhet të depozitojë një kopje të disertacionit në Bibliotekën Kombëtare.

PËR NJËSIMIN E TITUJVE AKADEMIK "PROFESOR" DHE "PROFESOR I ASOCIUAR"

Aplikimi për njohjen e titujve akademikë "Profesor" dhe "Profesor i asociuar", kryhet on-line sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet on-line në portalin e-albania. Këtij formulari i ngarkohet në format elektronik dokumentat që do të listohen më poshtë:

b) dokumenti i fitimit të titullit akademik, kopje e njësuar me origjinalin si dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar;

c) diploma e studimeve pararendëse universitare dhe/ose vërtetimi i njësimit të diplomës i lëshuar nga institucioni përgjegjës;

d) vërtetimin e regjistrimit të titullit akademik në databazë në zbatim të kuadrit ligjor të vendit përkatës;

e) Curriculum Vitae;

f) fotokopja e kartës së identitetit apo pasaportës (për shtetasit e huaj);

g) deklarata/skeda e nënshkruar në të cilin të jepet informacion, për:

i. eksperiencën akademike në mësimdhënie;
ii. aktivitetin shkencor;
iii. botime të punimeve shkencore në organe shkencore ndërkombëtare.

h) mandatpagesa ose konfirmimi i pagesës online.

The application for recognition of academic titles "Professor" and "Associate Professor", is performed on-line according to the following procedure:

a) the application form is completed on-line at the e-albania portal. The documents listed below will be uploaded to this electronically form:

b) the document of academic title, a copy attached to the original and translated into albanian by licensed translators;

c) diploma of pre-university studies and / or diploma certification issued by the responsible institution;

d) proof of registration of the academic degree in the database in accordance with the legal framework of the country concerned;

e) Curriculum Vitae;

f) photocopy of ID card or passport (for foreign nationals);

g) signed statement/file giving information on:

i. academic experience in teaching;
ii. scientific activity;
iii. publications of scientific works in international scientific bodies.

h) payment order or confirmation of online payment.

| | |
|---|---|
| *Në fletoren zyrtare Nr. 1 datë 15.01.2020 është publikuar Vendimi Nr. 6, datë 6.01.2020* ***"Për kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e masave të rimëkëmbjes ekonomike".*** | *In the Official Journal No. 1, dated 15.01.2020 is published the Decision Nr. 6, dated 6.01.2020* ***"On the conditions, criteria and procedures for implementing economic recovery measures".*** |
| Skema e mbështetjes së rimëkëmbjes ekonomike përfshin:<br>1. dhënien e përfitimeve të papunësisë për punëmarrës që kanë mbetur të papunë për shkak të shembjes, dëmtimit ose të zhvendosjes së vendit të punës;<br>2. mbështetjen financiare të tregtarëve dhe shoqërive tregtare, me qëllim rikonstruksionin e shpejtë të vendit të zhvillimit të aktivitetit tregtar. | The economic recovery support scheme includes:<br>1. providing unemployment benefits to employees who remain unemployed due to collapse, injury or displacement;<br>2. financial support of traders and companies, in order to quickly reconstruct the place of business development. |
| Përfitojnë nga masat e rimëkëmbjes ekonomike:<br>1. personat dhe tregtarët e shoqëritë tregtare, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në bashkitë dhe njësitë administrative, në territorin e të cilave është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore;<br>2. subjektet që kanë pësuar dëme në ndërtesa, jashtë territorit ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë, në rastet kur provohet se dëmet janë pasojë e fatkeqësisë natyrore. | Benefit from economic recovery measures:<br>1. persons and traders and business organizations exercising their economic activity in the municipalities and administrative units on whose territory has been declared natural disaster situation;<br>2. entities that have suffered damage to buildings outside the territory where the state of disaster is declared, in cases where the damage is proven to be a consequence of a natural disaster. |
| Nuk janë subjekte përfituese: Subjekte që janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, kur dëmi ka ardhur si rrjedhojë e gabimeve në projektimin apo ndërtimin e ndërtesës kryer prej vetë subjektit ndërtues që është njëkohësisht dhe pronar i objektit. | Not Beneficial Entities: Entities that have been damaged by a natural disaster when the damage is due to errors in the design or construction of the building carried out by the builder himself who is also the owner of the building. |
| Tregtarët dhe shoqëritë tregtare kërkojnë pranë njësive të vetëqeverisjes vendore ku ushtrojnë aktivitetin:<br>1. dhënien e përfitimeve të papunësisë për punëmarrësit e tyre; | Traders and companies request from the local self-government units where they operate:<br>1. providing unemployment benefits to their employees; |

| | |
|---|---|
| 2. mbështetjen financiare për rikonstruksionin e vendndodhjes së biznesit.<br><br>Kushtet për dhënien e përfitimeve të papunësise janë si më poshtë:<br><br>1. punëdhënësi të jetë një ndërmarrje e vogël apo dhe e mesme;<br>2. në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë natyrore, punëmarrësi të jetë në marrëdhënie pune të vërtetuar me pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, prej jo më pak se një muaj;<br>3. të mos jetë i punësuar ose i vetëpunësuar në një vend tjetër;<br>4. punëmarrësit të jenë të përfshirë në listat e miratuara nga njësia e vetëqeverisjes vendore.<br><br>Kushtet për mbështetjen financiare të tregtarëve dhe shoqërive tregtare janë, si më poshtë vijon:<br><br>1. Të kenë pësuar dëme materiale të pronës të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore, sipas aktkonstatimit të Institutit të Ndërtimit, dhe kanë ndërprerë aktivitetin e tyre ekonomik, si pasojë e dëmtimit dhe/ose zhvendosjes së tij, për rikuperimin e të cilave kërkohet:<br>i. riparim, rikonstruksion ose rindërtimin i ndërtesave për qëllime prodhimi dhe shërbimi;<br>ii. mbulim i dëmtimeve të pasurive të paluajtshme e të luajtshme, përfshirë stoqet dhe magazinat;<br>iii. për zhvendosjen e aktivitetit ekonomik të tyre, brenda të njëjtës njësi të vetëqeverisjes vendore, për një masë zhdëmtimi, që nuk e tejkalon dëmin që ka pësuar ndërtesa, në kuptim të nënndarjes "i" më lart. | 2. financial support for the reconstruction of the business location.<br><br>The conditions for granting unemployment benefits are as follows:<br><br>1. the employer is a small or medium-sized enterprise;<br>2. in the event of a natural disaster, the employee shall be in a working relationship certified by the payment of social and health insurance contributions of not less than one month;<br>3. not be employed or self-employed in another country;<br>4. the employees are included in the lists approved by the local self-government unit.<br><br>The conditions for the financial support of traders and companies are as follows:<br><br>1. Have suffered material property damage caused by a natural disaster, according to the ascertainment act by the Institute of Construction, and have interrupted their economic activity as a result of damage and / or displacement for which recovery is required:<br>i. repair, reconstruction or reconstruction of buildings for production and service purposes;<br>ii. coverage of damage to real estate, including stocks and warehouses;<br>iii. for the relocation of their economic activity within the same unit of local self government for a measure of indemnity not exceeding the damage suffered by the building in the sense of subdivision "i" above. |

| | |
|---|---|
| Afati: Kërkesat për të përfituar dhënien e përfitimit të papunësisë dhe të mbështetjes financiare bëhen pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ndodhet selia e ndërmarrjes, brenda tre muajve nga shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.<br><br>*Në fletoren zyrtare Nr. 3 date 20.01.2020 është publikuar Ligji Nr. 87/2019* ***"Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit"***<br><br>Qëllimi i këtij ligji është:<br>Përcaktimi i parimeve, rregullave, kritereve, detyrimeve, afateve dhe procedurave që duhet të ndiqen nga tatimpaguesit dhe prodhuesit e mirëmbajtësit e zgjidhjeve software-ike, lidhur me lëshimin e faturës, faturën shoqëruese dhe faturën elektronike, përmbajtjen e faturave, regjistrimin e të dhënave dhe procedurën e fiskalizimit të lëshimit të faturave, marrjen e informacionit të pagesave, cerfitikimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji.<br><br>Neni 4 i ligjit parashikon tatimpaguesit që duhet të lëshojnë faturë. Tatimpaguesit, që duhet të lëshojnë faturë, pavarësisht nga qarkullimi vjetor i realizuar në vitin paraardhës ose në atë aktual, janë personat juridikë dhe fizikë:<br><br>a) të cilët janë tatimpagues të tatimit mbi fitimin, në përputhje me ligjin për tatimin mbi të ardhurat;<br>b) të cilët janë tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sistemin e taksave vendore;<br>c) të cilët janë tatimpagues që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar, pavarësisht nga forma e organizimit, përfshirë organizatat jofitimprurëse, njësitë e zbatimit të projekteve, organet publike qendrore e vendore, organizatat politike dhe institucione të tjera të ngjashme; | Deadline: Applications to receive unemployment benefit and financial support are made to the local self-government unit where the company is located, within three months of the announcement of the natural disaster.<br><br>*In the Official Journal No.3, dated 20.01.2020 is published the Law No. 87/2019* ***"On Invoice and circulation monitoring system"***<br><br>The purpose of this law is:<br>To define the principles, rules, criteria, obligations, deadlines and procedures to be followed by taxpayers and manufacturers and maintainers of software solutions, regarding invoice issuance, accompaying invoice and electronic invoice, invoice content , registration of data and the procedure of fiscalizing the issuance of invoices, obtaining payment information, certification and supervision of the implementation of this law.<br><br>Article 4 of the law provides the taxpayers who shall issue invoices. Taxpayers who must issue invoices, regardless of the annual turnover realized in the previous year or the current year, are the legal and natural persons:<br><br>a) who are taxpayers of income tax, in accordance with the law on income tax;<br>b) who are taxpayers of the simplified income tax for small business, in accordance with the legislation in force on the local tax system;<br>c) who are taxpayers exercising economic activity, in accordance with the applicable legislation on value added tax, irrespective of the form of organization, including non-profit organizations, project implementation units, central and local public bodies, political |

| | |
|---|---|
| ç) të cilët janë tatimpagues rezident ose jorezident, pavarësisht nga forma e organizimit, kur furnizojnë mallra ose shërbime për organet publike, përveçse kur një organ publik i nënshtrohet TVSHsë dhe ka detyrimin të lëshojë një faturë si marrës i mallrave ose shërbimeve;<br>d) të cilët janë tatimpagues jorezidentë, për furnizimin e shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, kur, në përputhje me legjislacionin tatimor, sipas përcaktimeve në shkronjat "a", "b" e "c", të këtij neni, u nënshtrohen detyrimeve tatimore në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet një përfaqësuesi tatimor. | organizations and others similar institutions.<br>ç) who are resident taxpayers or nonresident, regardless of the form of organization, when supplying goods or services to public bodies, except when a public body submits VAT and has the obligation to issue one invoice as receiver of goods or servic;<br>d) who are non-resident taxpayers for the supply of services in the Republic of Albania, when, in accordance with the tax legislation, as defined in letters "a", "b" and "c" of this Article, they are subject to tax liabilities in the Republic of Albania through a tax representative. |
| <u>Tatimpaguesit që përjashtohen nga detyrimi për të lëshuar faturë.</u><br>Tatimpaguesi nuk është i detyruar të lëshojë faturë për llojet e veprimtarive dhe për furnizimin e mallrave e të shërbimeve si më poshtë:<br>a) për prodhuesit bujqësorë, që janë ose jo subjekte të skemës së kompensimit, në përputhje me legjislacionin për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë;<br>b) për shitjen e biletave ose kuponave nga shoferi i një mjeti transporti pasagjerësh në linjat e transportit publik urban, në përputhje me vendimet e njësive të vetëqeverisjes vendore;<br>c) për furnizimin e mallrave e të shërbimeve nga persona fizikë të regjistruar në administratën tatimore si "ambulantë". | <u>Taxpayers exempted from the obligation to issue an invoice.</u><br>The taxpayer is not obliged to issue invoices for the types of activities and for the supply of goods and services as follows:<br>a) for agricultural producers, whether or not subject to the compensation scheme, in accordance with the legislation on value added tax in the Republic of Albania;<br>b) for the sale of tickets or coupons by the driver of a passenger vehicle on urban public transport routes, in accordance with the decisions of the local self-government units;<br>c) c) for the supply of goods and services by natural persons registered with the tax administration as "costermonger". |
| Ligji parashikon specifikat për lëshimin e;<br>1. Faturave të thjeshta;<br>2. Faturave për pagesa me para në dorë;<br>3. Faturave Elektronike;<br>• Faturave elektronike për pagesa me para në dorë;<br>• Faturave elektonike për pagesa pa para në dorë; | The law provides the specifics of issuance of;<br>1. Simple invoices;<br>2. Cash payment invoices;<br>3. Electronic invoices;<br>• Electronic invoices for cash payments;<br>• Electronic invoices for cashless payments; |

| | |
|---|---|
| • Faturave elektronike në transaksionet me organet publike;<br>4. Fatura Shoqëruese.<br><br>Nëse dëshironi të dini më shumë për ndryshimet në legjislacionin Shqipëtar, na kontaktoni si më poshtë:<br>Email: info@arsfirm.al<br>Telefon: +355 69 97 89 625<br>Web: www.arsfirm.al<br><br>**Adresa e zyrës**<br>Rruga "Kavaja"<br>Qendra " Sun Tower "<br>8 Kati, Apt nr. 30<br>Tiranë, Shqipëri<br><br>**©A.R.S Legal & Financial Services** | • Electronic invoices in transactions with public bodies;<br>4. Accompanying Invoice.<br><br>If you wish to know more Albanian legislation changes, contact us as follows:<br><br>Email: info@arsfirm.al<br>Phone: +355 69 97 89 625<br>Web: www.arsfirm.al<br><br>**Office Address**<br>“Kavaja” Street<br>“Sun Tower” Center<br>8th Floor, Apt no. 30<br>Tirana, Albania<br><br>**©A.R.S Legal & Financial Services** |